European Commission
http://ec.europa.eu/languages/day2011/

European Day of Languages
www.coe.int/EDL

DIRECTORATE OF EDUCATION AND LANGUAGES

DEKLARATË E PËRBASHKET E KËSHILLIT TË EUROPËS DHE KOMISIONIT EUROPIAN PER 10-VJETORIN E DITËS EUROPIANE TË GJUHËVE, 26 SHTATOR 2011

(PJESË TË ZGJEDHURA)

Respekti për shumëllojshmërinë gjuhësore dhe kulturore dhe të mësuarin e gjuhëve janë të gjitha parime thelbësore të Këshillit të Europës dhe Komisionit Europian. Aftësia për të kuptuar dhe përdorur disa gjuhë ndihmon qytetarët të jenë të aftë nga ana shoqërore dhe profesionale. Aftësitë gjuhësore janë thelbësore për barazinë dhe integrimin. Kundrejt sfondit aktual të lëvizjes së lirë, globalizimit të ekonomisë dhe ndryshimit të rrymave ekonomike, nevoja për të mësuar gjuhë të huaja dhe për të zhvilluar një edukim shumëgjuhësor dhe ndërkulturor është më e dukshme se kurrë më parë.

Më 2001, Këshilli i Europës, në bashkëpunim me Komisionin Europian, iniciuan të parin Vit Europian të Gjuhëve me qëllim ndërgjegjësimin për trashëgiminë e pasur gjuhësore europiane, për të inkurajuar shumëgjuhësinë në shoqëri dhe për të motivuar qytetarët për të mësuar më shumë gjuhë.

Mbështetur në suksesin e këtij viti, gjuhët dhe të mësuarit e gjuhëve që nga ajo ditë janë festuar çdo 26 shtator, si Dita Europiane e Gjuhëve. Veprimtaritë mbulojnë të gjitha gjuhët, duke përfshirë dhe promovimin e gjuhëve më pak të përdorura dhe të mësuara, pa lënë mënjanë gjuhët e emigrantëve dhe gjuhën e shenjave. Dita Europiane e Gjuhëve duhet të inkurajojë të mësuarin e gjuhëve gjatë gjithë jetës për formim personal, pjesëmarrje të plotë në shoqërinë demokratike europiane dhe zhvillimin profesional.

Më 2011, me rastin e 10-vjetorit të Ditës Europiane të Gjuhëve, Këshilli i Europës dhe Komisioni Europian mirëpresin progresin e përbashkët bërë gjatë dekadës së fundit. Të dy organizatat e rikonfirmojnë angazhimin e tyre në promovimin e politikave dhe praktikave të gjuhës në përputhje me vlerat dhe parimet e tyre të përbashkëta, dhe qëllimin e tyre për të vazhduar të kërkojnë sinergji midis veprimeve të tyre përkatëse në Bruksel dhe në Strasburg, duke përfshirë dhe ato të zbatuara nga Qendra Europiane e Gjuhëve Moderne në Graz.

Në të ardhmen, Këshilli i Europës dhe Komisioni Europian do të vazhdojnë të punojnë në bashkëpunim të ngushtë për të sjellë përfitimet e shumëllojshmërisë gjuhësore në Europë më afër qytetarëve europianë, Bashkëpunimi midis dy organizatave do të shërbejë për të nxitur zhvillimin e kompetencave gjuhësore për sa më shumë gjuhë të jetë e mundur, në mënyrë që të rrisin respektin e ndërsjellë, përmirësimin e punësimit dhe lëvizshmërinë dhe për të lehtësuar integrimin dhe qytetari aktive në shoqëritë demokratike shumëgjuhësore të Europës.

Për Komisionin Europian

Androulla Vassiliou

Komisionere për Arsimin, Kulturën,
Shumëgjuhësinë dhe Rininë

Për Këshillin e Europës

Thorbjørn Jagland

Sekretar i Përgjithshëm